

AKTI I THEMELIMIT
i Shoqerise Anonime
"TERMOCENTRALI Vlore"

Sot me 28/07/2007, ne Tirane u hartua ky akt themelimi nga z.Gjergj BOJAXHI, Drejtor i Pergjithshem i KESH sh.a., si perfaqesues i Aksionerit te Vetem, KESH sh.a. si me poshte vijon:

Neni 1
Themelimi dhe Emri i Shoqerise

- 1.1. Themelohet Shoqeria aksionere "TERMOCENTRALI VLORE". Shoqeria, eshte person juridik sipas te drejtes shqiptare, eshte shoqeri anonime pa oferte publike.
- 1.2. Emri i shkurtuar i Shoqerise eshte "TEC-i Vlore" sh.a. Shoqeria do ta zhvilloje veprimtarine e saj sipas statutit te saj, ketij Akti Themelimi dhe legjislacioni perkates ne fuqi.
- 1.3. Shoqeria ka vulen e saj me emrin "TEC-i Vlore" i shoqeruar me gerrat sh.a. qe tregojne tipin e shoqerise.

Neni 2
Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne Bllokun "Vasil Shanto", Tirane, Shqiperi. Shoqeria mund te zhvilloje veprimtarine e saj ne te gjitha territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 3
Objekti i Shoqerise

- 3.1. Shoqeria do te angazhohet ne veprimtarite e meposhtme:
 - 3.1.1. Prodhimi i energjise elektrike;
 - 3.1.2. Importi, eksporti dhe furnizimi i energjise elektrike;
- 3.2. Shoqeria do te realizoje cdo operim tregtar dhe financiar lidhur direkt ose indirekt me objektin e saj sipas dispozitave te legjislacionit ne fuqi.
- 3.3. Shoqeria do te beje te gjitha perpjekje per te marre lejet, autorizimet, licensat dhe cdo miratim tjeter te nevojshem qe kerkoet per te kryer veprimtarine e saj

Neni 4
Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise eshte e papercaktuar. Kohezgjatja e Shoqerise mund te ndryshoje me vendimin e Asamblese se Aksionereve.



Neni 5
Kapitali Themeltar dhe Aksionet

- 5.1. Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 2'000'000 (dy milion) leke dhe ai eshte ndare ne 2'000 (dymije) aksione me vlere nominale 1'000 (njemije) leke per cdo aksion. I gjithe kapitali themeltar paguhet dhe nenshkruhet nga aksioneri i vetem KESH sh.a.
- 5.2. Aksionet jane nominative dhe mund te transferohen lirisht sipas legjislacionit ne fuqi.
- 5.3. Kapitali i Shoqerise mund te rritet ose zvogelohet sic mund te kerkoet per operimin e Shoqerise dhe sic parashikohet nga legjislacioni ne fuqi.
- 5.4. Aksioneri i vetem do te jete pergjegjes per cdo humbje te Shoqerise deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 6
Pergjegjesite kryesore te aksionerit

- 6.1. Pergjegjesite kryesore te aksionerit te vetem jane si me poshte:
 - 6.1.1. Te paguaje dhe nenshkruaje kapitalin themeltar te Shoqerise;
 - 6.1.2. Te rregjistroje Shoqerine ne gjykate;
 - 6.1.3. Te siguroje investimet e nevojshme per fillimin e veprimtarise;

Neni 7
Te drejtat e aksionerit

- 7.1. Te drejtat e aksionerit jane si me poshte:
 - 7.1.1. Te marre fitim nga Shoqeria;
 - 7.1.2. Te emeroje keshillin mbikqyres;

Neni 8
Ushtrimi financiar i Shoqerise

Ushtrimi financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht, ushtrimi financiar i pare do te filloje ne ditene e regjistrimit te Shoqerise ne gjykate dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor 2007.

Neni 9
Organet drejtuese

Organet drejtuese te Shoqerise jane Keshilli Mbikqyres dhe Drejtori i Pergjithshem.



Neni 10
Perberja e Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres i pare perbehet nga:

1. Sahit Dollapi
2. Aida Hoxha
3. Suzana Guxholli (Pani)
4. Allion Cenolli
5. Juliana Lamaj
6. Ilir Zeqo

Neni 11
Ekspertet Kontabel te autorizuar

Auditimi i Shoqerise do te behet nga eksperte kontabel te autorizuar te emeruar nga Asambleja e Aksionereve.

Ekspertet e pare kontabel te autorizuar te Shoqerise jane:

1. Diana Golemi
2. Kosta Nika.

Ky Akt Themelimi i Shoqerise hartohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe.

PER AKSIONERIN E VETEM
DREJTORI I PERGJITHSHEM

GJERGJ BOJAXHI

